



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2019:158026

Datë: 07.11.2023

Numri i dokumentit: 04882721

C.nr.492/2018

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Nazmi Neziri, dhe procesmbajtësen Afërdita Ejupi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit të mitur D. D. nr. personal, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi ligjor prindi M. D. nr. personal, nga Podujeva, Rruga “M.” pn., e të cilët i përfaqëson i autorizuari “Avokatura MBN” SH.P.K., me përfaqësues M. S., B. S. dhe N. S., avokat nga Prishtina, Rruga “U..”, Hyrja ..., kati I-rë, nr.5, me autorizim, kundër të paditurës **1. K. B. I – K.** nga Podujeva, Rruga “B.” pn., të cilën e përfaqëson e autorizuari M. H., avokat nga Podujeva, Rruga “.. N.”, pn., me autorizim, dhe **2. Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A. (KEDS)**, në Prishtinë, sheshi “B. K.”, nr., të cilën e përfaqëson i autorizuari A. K., me autorizim, me objekt kontesti kompensim dëmi, me vlerë të kontestit: 30,800.00 Euro, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur më datën 25.10.2023, në prani të palëve ndërgjyqëse të autorizuarit të paditësit, dhe në prani të autorizuarit të paditurës së parë dhe të autorizuarit të paditurës së dytë, ndërsa me datën 01.11.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësit-të miturit D. D., të cilin e përfaqëson përfaqësuesi ligjor prindi M. D. nga Podujeva, Rruga “M.” pn., **si e bazuar**, dhe:

II. DETYROHEN të paditurat **1. K. i B. I – K.** nga Podujeva, Rruga “B.” pn., dhe **2. Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A. (KEDS)**, në Prishtinë, sheshi “B. K.”, nr..., që paditësit në mënyrë solidare t’ia kompensojnë dëmin material dhe jo material, të pësuar në aksidentin e datës 05.06.2018, dhe atë:

Dëmin jo material:

- Në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej 4,600.00 €
- Në emër të frikës së pësuar, shumën prej 4,400.00 €
- Në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor (shkallë 10%), shumën prej 4,500.00€
- Në emër të shëmtimit trupor – shkallë e mesme, shumën prej 3,800.00 €

Dëmin material:

- Në emër të ndihmës dhe përkujdesit të huaj, shumën prej 500.00 €
- Në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 420.00 €

III. Refuzohet kërkesa e paditësit përtej shumës së aprovuar në emër të dëmit jo material dhe material, në shumë prej 12,580.00 €, **si e pabazuar**.

IV. DETYROHEN të paditurat 1. K. i B. I. – K.. nga Podujeva, Rruga “B.” pn., dhe 2. Kompania Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A. (KEDS), në Prishtinë, sheshi “B. K.”, nr., që shumat e aprovuara t’ia paguajnë paditësit, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar ti llogaritet nga dita e seancës së shqyrtimit kryesor të dt.25.10.2023 e deri në pagesën përfundimtare, si dhe t’ia paguajnë në mënyrë solidare shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 3,562.00 Euro, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësit, nëpërmes të autorizuarit të tij ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadija dhe të detyrohen të paditurat që në mënyrë solidare paditësit t’ia kompensojnë dëmin siç është precizuar lartësia e kërkesëpadiisë me parashtrësën e dt.28.09.2023, në tërësi si të bazuar, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe ti kompensohen shpenzimet e procedurës.

Ka shtuar se mbetemi pranë padisë dhe kërkesës se saj me të cilën kemi kërkuar që të obligohet e paditura që paditësit ti kompensoj dëmin e pësuar në incidentin e ndodhur me dt.05.06.2018. Sa i përket përgjegjës në padi nga e paditura K.. në Podujevë, pretendimet e paraqitura janë të pa arsyeshme dhe në kundërshtim me provat që gjinden në provat e lëndës, sepse nga provat në shkresat e lëndës vërtetohet se paditësi brenda hapësirave të K.. Podujevë ka pësuar lëndime. Fakti se zyrtari i të paditurës është liruar nga fajësia në procedurë penale nuk përjashton edhe përgjegjësinë e institucionit për dëmin që mund tu ketë shkaktuar personave të tretë.

Më tej ka shtuar se nga shkresat të cilat janë administruar në seancën e datës 25.10.2023, është vërtetuar se me datë 05.08.2018 paditësi derisa ka qenë duke lozur, ka hyrë në hapësirat ku ka qenë duke u ndërtuar Xhamia e re dhe i njëjti ka rënë në kontakt me telat e rrymës. Deri te ky moment ka ardhur për shkak se punëkryesi, K. i B. I. në Podujevë, nuk i ka ndërmarrë masat e nevojshme për tu siguruar që gjatë ekzekutimit të punëve nuk do të ketë mundësi që persona të paaautorizuar të hyjnë në atë vend punishte, e posaçërisht për fëmijët. Po ashtu, për shkak se e paditura e dytë KEDS nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme që i takojnë me ligj për ti kryer, ashtu që në mënyrë të sigurt të ushtroj veprimtarinë e saj (furnizimin me energji elektrike), ka ardhur deri te kontakti i paditësit me telat e rrymës. Të paditurat nuk kanë ndërmarrë as veprimet minimale për të siguruar hapësirat ku janë duke u kryer punët, sepse me ndonjë rrethojë sa do të vogël paditësi i moshës 9 vjeçare nuk do të mund të kalonte në atë hapësirë, dhe po ashtu nuk do të mund të vinte në kontakt sikur sadopak telat e rrymës të ishin ngritur më lart.

Këto rrethana i vërteton edhe ekspertiza e sigurisë në punë e datës 03.05.2023, e cila ka konstatuar se përgjegjës për ndodhjen e aksidentit janë të dy të paditurat në mënyrë solidare për shkak të mos marrjes së veprimeve të nevojshme për evitimin e rreziqeve. Eksperti ka prezantuar në seancën, ku palët ndërgjyqëse të interesuara kanë parashtruar pyetjet dhe sqarimet e nevojshme, ndaj të cilave eksperti është përgjigjur, dhe asnjëra nga palët ndërgjyqëse nuk kanë

pas propozime të reja për ekspertizë tjetër të kësaj natyre. Andaj, në bazë të këtyre provave dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së, mjaftueshëm është vërtetuar gjendja faktike lidhur me ndodhjen e aksidentit dhe përgjegjësit për shkaktimin e tij.

Ka shtuar se sa i përket lartësive të kategorive të kompensimit, shumat e kërkuara me precizimin e kërkesëpadisë janë në pajtim të plotë me praktikën gjyqësore, me lëndimet e pësuar, pasojat e mbetura, e të gjitha këto të vërtetuara me mendimin profesional të marrur nga ekspertët.

Andaj, gjykatës i ka propozuar që duke pasur parasysh deklaratimet e theksuara, provave në dosje të lëndës, padinë dhe kërkesën e saj ta aprovoi në tërësi si të bazuar, gjithnjë duke pasur parasysh lëndimet e pësuar nga paditësi dhe pasojat e mbetura tek ai, pa fajin e tij.

Shpenzimet i ka kërkuar siç janë theksuar në parashtrësën me shkrim.

E paditura e parë KBI në Podujevë, nëpërmes të autorizuarit të saj në të përgjigjur në padi, seanca e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi duke i propozuar gjykatës që të njëjtën ta refuzoi si të pabazuar. Ka shtuar i kundërshtoj në tërësi propozimet për ekspertizën e punës dhe atë mjekësore, e kundërshtoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit në këtë çështje pasi që e njëjta nuk ka kurrfarë baze juridike. Paditësi duhet të precizoj padinë në aspektin subjektiv pasi që si e paditur në këtë rast duhet t jetë vetëm një palë dhe ajo është KEDS, e paditura KBI në Podujevë nuk i ka shkaktuar asnjë dëm paditësit sipas dispozitave të LMD-së, kurse përgjegjës për kompensim është personi që në mënyrë të paligjshme dhe me faj i shkakton tjetrit një dëm në persona dhe në pasurinë e tij detyrohet që të kompensoi dëmin e shkaktuar. Ka theksuar se nëse dikush kërkon dëmshpërblim nga personi tjetër duhet të ketë një vendim të formës se prerë të çështjes penale se kush është fajtor për këtë dëmtim, andaj ne i kemi dozuar gjykatës një kopje të vendimit penale P.nr.148/2020 ku përfaqësuesi i KBI është liruar nga të gjitha pikat e aktakuzës, gjegjësisht prokurori i shtetit është tërhequr nga ndjekje penale. Pa vepër penale nuk mund të fajësoni askënd dhe të kërkon dëmshpërblim.

Ka shtuar më tej se paditësi vetëm ka bërë kërkesë të hiperbolizuar shumë e kërkesave të pabazuara fare në faktet e ofruara. I padituri ka tërë dokumentacionin legal për ndërtimin e këtij objekti. Prandaj, i ka propozuar gjykatës që nga provat e ofruara si dhe dispozitave ligjore të aplikueshme ta hudhë poshtë padinë dhe kërkesëpadinë kundër të paditurës, e cila nuk ka kurrfarë baze.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Përfaqësuesi i të paditurës së dytë "KEDS", në përgjigje në padi dhe seanca e ka kontestuar në tërësi bazën juridike të kërkesëpadisë së paditësit për shkak të parashkrimit. Ka shtuar se mbetemi pranë propozimit për abrogimin e aktvendimit për ndryshimin e padisë në aspektin subjektiv për faktin se KEDS-it nuk i ishte marrë pëlqimi për zgjerimin e padisë së paditësit. Me pranimin e aktvendimit për përgjigje në padi provat e bashkangjitura me padinë dhe parashtrësën e paditësit përpos që nuk mbështesin pretendimet e tij ndaj KEDS-it. Ne e kundërshtojmë kërkesëpadinë e paditësit ngase padisë i mungon edhe baza juridike e saj si dhe nga pretendimet e paditësit vërehet se KEDS-it i mungon edhe legjitimiteti real pasiv në procedurë, ngase këtu kemi të bëjmë me përgjegjësi eventuale të paditurës së parë dhe të dytë, të cilat janë përgjegjëse për ndërtimin e objektit dhe për shkak të mos respektimit të normave përkatëse dhe vendimeve gjatë zhvillimit të punimeve në këtë objekt ka ardhur edhe deri te shkaktimi i dëmit ndaj paditësi.

Ka theksuar se në secilin rast konsiderojmë se meqë dëmi është shkaktuar me dt.05.06.2018, ndërsa kërkesa e paditësit ndaj KEDS-it për herë të parë është paraqitur me dt.30.03.2022 me parashtrësën për zgjerimin e padisë në aspektin subjektiv kemi të bëjmë me parashkrimin e kërkesëpadisë sipas dispozitave të nenit 357 të LMD-së, që ka të bëjë me kërkesat për shpërblimin e dëmit e që në këtë rast kanë kaluar me tepër se tri vite. Më tej ka shtuar se gjatë shqyrtimit dhe administrimit të provave u vërtetua se e paditura KEDS nuk bartë asnjë përgjegjësi sa i përket dëmit të shkaktuar nga kishte pësuar lëndime paditësi, ngase nga të gjitha këto prova vërtetohet se e paditura e dytë nuk kishte asnjë lidhje kauzale me dëmin e shkaktuar, dhe duke mos qenë përgjegjës për shkaktimin e dëmit, ku u vërtetua se përgjegjëse për dëmin e shkaktuar me veprimet e saj ishte ekskluzivisht e paditura e parë, pasi që e paditura e dytë kishte marrë të gjitha veprimet përkatëse për të cilat ka qenë e obliguar t'i ndërmerr.

Prandaj, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ndaj të paditurës së dytë ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e të provuarit me propozimin e palëve i ka administruar këto prova: është bërë dëgjimi i dëshmitarëve I. H. dhe N. F., si dhe:

U lexua Procesverbali mbi intervistomini e dëshmitarit – anketuesit – viktimës i hartuar nga Policia e Kosovës, Stacioni Policor në Podujevë numër të rastit 2018-AF-.... dt.08.06.2018, së bashku dhe tabela e përmbajtjes, Raporti i shpejt dt.07.06.2018, Raporti fillestar dt.06.06.2018, Raporti i Oficerit dt.06.06.2018, Raporti i Policit hetues 06.06.2018, Procesverbali mbi intervistimin e dëshmitarit ankuesit-viktimës i hartuar nga Policia e Kosovës, Stacioni Policor në Podujevë numër të rastit 2018-AF-.... dt.06.06.2018, Njësia e hetimeve, Stacioni Policor me numër PP.II.4275/18, dt.30.07.2018, Kallëzim Penal numër 2018-AF-.... dt.12.07.2018, Procesverbali mbi intervistimin e të dyshuarit i hartuar nga Policia e Kosovës, Stacioni Policor në Podujevë numër të rastit 2018-AF-... të dt.07.07.2018, Procesverbali mbi intervistimin e dëshmitarit – anketuesit – viktimës i hartuar nga Policia e Kosovës – Stacioni Policor në Podujevë numër të rastit 2018-AF-.... .07.06.2018, Fletëlëshim lëshuar nga QKUK Prishtinë Reparti i Kirurgjisë Plastike numër amze ..., Udhëzim për konsultë numër dt.06.06.2018 në emër të D. D., Raporti nga konsulta dt.25.07.2018, Çertifikata e lindjes numër të referencës 19/2009RL/.... numër rendor lëshuar nga ZGJC në Prishtinë me dt.12.09.2018, Kopja e pasaportës numër... lëshuar nga MPB, RKS në emër të D. D., përgjigje në padi nga e paditura BIK dt.14.03.2022, leje ndërtimi lëshuar nga Komuna e Podujevës numër 07-..... në emër të K. i B. I. dt.06.10.2016, Parashtrësë e përfaqësuesit të paditësit për zgjerimin e padisë në aspektin subjektiv dhe objektiv i provave dt.30.05.2022, Procesverbal i dt.12.05.2022 në të cilin zgjerimin e padisë, Përgjigje në padi e të paditurisë së dytë KBI dt.27.05.2022, Aktvendim i kësaj Gjykate i hartuar në procedurën Penale me numër P.nr.148/2020 dt.29.10.2020, i plotfuqishëm me dt.27.11.2020, Parashtrësë nga Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike Sh.a (KEDS) në Prishtinë dt.07.07.2022, Procesverbal i dt.07.07.2022, Raport Specialistik dt.21.03.2019, Raport Specialistik dt.06.11.2019, Udhëzim për konsultim numër dt.20.08.2018, në emër të D. D., fotot e paditësit, Procesverbal i dt.06.09.2023, parashtrësë e

përfaqësuesit të paditësit dt.19.09.2022, Kushtetuta e B. I. dt.06.10.2022, Procesverbal i dt.06.10.2022, Parashtrësë e përfaqësuesit të paditësit për tërheqjen e padisë kundër të paditurës Bashkësia Islame e Kosovës, BIK dt.14.10.2022, Procesverbal i dt.03.11.2022, Ekspertizë për dhënien e mendimit profesional nga lëmia e sigurisë dhe mbrojtjes në punë dt.03.05.2023 e hartuar nga eksperti Dr.Sc. Gj. V., Fatura për pagesën e ekspertit të punës Dr. Sc. Gj. V. dt.05.06.2023 lëshuar nga NLB Banka, Procesverbal i dt.20.06.2023, Procesverbal i dt.18.07.2023, Ekspertizë Mjekësore dt.24.08.2022, e hartuar nga ekspertit Dr. S. D. Ortoped-Traumatolog, Dr. B. B. – Kirurg, Dr. Sh. H. Psikiatër, Fatura për pagesën e ekspertit të punës Gj. V. dt.05.06.2023 lëshuar nga NLB Banka, Fatura për pagesën e ekspertit të punës Dr. Sh. H. Ambulanca Psikiatrike dt.28.09.2023 lëshuar nga NLB Banka, Fatura për pagesën e ekspertit të punës Dr. B. B. dt.28.09.2023 lëshuar nga NLB Banka, Parashtrësë e paditësit për ndryshimin dhe zmadhimin e lartësisë së kërkesëpadisë dt.28.09.2023, Procesverbal i dt.28.09.2023, Procesverbalin numër i hartuar nga KEDS dt.24.04.2018.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i LPK-së, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Meqë ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit nga ana e të paditurave si për nga baza ashtu dhe lartësia e saj, për sa i përket shkaktarit si dhe kontributit në shkaktimin e aksidentit, duke e kontestuar kërkesëpadinë e paditësit edhe mbi bazën e asaj se në rastin konkret ju mungon legjitimiteti pasiv-real për të qenë palë dhe se padia e paditësit është ushtruar pas kalimit të afatit të përcaktuar ligjor për çka e njëjta dhe është parashkruar, andaj edhe vetë e drejta në kompensimin e dëmit të paditësit ndaj të paditurave është parashkruar.

Gjykata, pas deklaramit të palëve ndërgjygjëse thënieve në padi dhe përgjigjes në padi, si dhe deklaramit të tyre në seanca, vlerësimin të provave në shkresat e lëndës si dhe konsultimit në dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së), i cili gjen zbatim në rastin e paditësit si ligj në fuqi kur është shkaktuar aksidenti në të cilin ka pësuar lëndimet trupore-dëm paditësi, pasi që pala e paditur është thirrur në parashkrim të kërkesëpadisë së paditësit duke kontestuar kështu bazën, gjykata i vlerësoj pretendimet e palës paditëse dhe kundërshtimet e të paditurave dhe erdhi në përfundim se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës dhe vetë të drejtës së palës paditëse për këto arsye:

Me dispozitat e nenit 358 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së), të cilat rregullojnë çështjen e parashkrimit të kërkesës, ku është përcaktuar se: *“Kur dëmi është shkaktuar me vepër penale dhe për ndjekjen penale është parashikuar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblim të dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale.”*. Ndërsa në paragrafin 2 është përcaktuar se: *“Ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale sjell edhe ndërprerjen e parashkrimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit.”*, afati i privilegjuar për të cilin në rastin konkret sipas bindjes së kësaj gjykate gjen zbatim në rastin e paditësit, meqë në rastin konkret

është vërtetuar se ekziston vepra penale¹, përkundër se në rastin konkret kemi aktvendim të formës së prerë me të cilin ndaj të pandehurit në këtë rast është hedhur aktakuza ngase prokurori është tërhequr në mungesë të provave dhe është pushuar procedura penale.

Nga prova Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, i nxjerrë në procedurën penale me numër P.nr.42/2015 të datës 13.01.2016, gjykata vërtetoi faktin se me rastin e shkakimit të aksidentit-ngjarjes ku ka pësuar i dëmtuari, si pasojë e veprimeve të ndërmarra me rastin e ndërtimit të objektit i cili ishte në ndërtim e sipër, të cilin e ka drejtuar KBI këtu e paditura e parë, si pasojë e veprimeve të ndërmarra është kryer veprë penale Punimet ndërtimore të kundërligjshme nga neni 368 par.5 lidhur me par.2 të Kodit Penal Nr. 04/L-082 të Republikës së Kosovës (KPRK-së), për të cilën veprë konform dispozitave të cituara në fuqi ka qenë i paraparë dënimi për veprën e kryer penale nga pakujdesia deri në tre (3) vjet dënim me burgim, e që për rrjedhojë të kësaj padia për shpërblimin e dëmit është ushtruar në gjykatë brenda afatit të përcaktuar ligjor për parashkrim të kërkesës.

Gjykata me aktvendim e cituar më lart, ka vërtetuar dhe faktin se është hudhur aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.4275/2018 e datës 13.03.2020 dhe është pushuar procedura penale ndaj të pandehurit për shkak të tërheqjes nga ndjekja penale në mungesë të provave, nga fakti se kjo përbënë pengesë ligjore për zhvillimin e mëtejshëm të procedurës penale, ndërsa në pikën II, të dispozitivit të këtij aktvendimi pala e dëmtuar nga ky aksident këtu paditësi- mituri me përfaqësuesin e tij ligjor, për realizmin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil e që paditësi dhe ka vepruar me ngritjen e padisë në këtë gjykatë me datën 04.10.2018, kurse me datën 13.03.2022 këtë padi e ka zgjeruar dhe ndaj tani këtu të paditurave KEDS dhe KBI.

Meqë, aksidenti ka ndodhur me 05.06.2018, ndërsa paditësi ka ushtruar padinë me datën 04.10.2018 kurse zgjerimin e padisë ndaj të paditurës KEDS dhe KBI, në gjykatë me datën 30.03.2022, ndërsa Aktvendimi penal P.nr.148/2020 për pushimin e procedurës penale është nxjerrë me datën 29.10.2020 dhe se nga ky moment e deri në paraqitjen e padisë kundër të paditurave KEDS dhe KBI, kanë kaluar më pak se 2 vite, me saktësisht 1 vit, 5 muaj e 1 ditë. Atëherë, në rastin konkret rezulton se padia për kompensimin e dëmit është paraqitur në kuadër të afatit të përcaktuar (afatit të privilegjuar) për parashkrimin e kërkesës, nga fakti se ndërprerja e parashkrimit të kërkesës është shkaktuar me zhvillimin e procedurës penale², si dhe me çdo veprim të paditësit në drejtim të realizimit të kërkesës së tij. Pra afati për kompensimin e dëmit të shkaktuar me veprën penale fillon të rrjedhë nga dita kur të skadojë koha e parashkrimit të ndjekjes penale.

Në rastin konkret ekziston dhe Aktvendimi penal P.nr.148/2020 të datës 29.10.2020, me të cilin është pushuar procedura penale ndaj të pandehurit si pasojë e dyshimit se i njëjti ka kryer veprën penale të Punimet ndërtimore të kundërligjshme nga neni 368 par.5 lidhur me par.2 të Kodit Penal Nr. 04/L-082 të Republikës së Kosovës, për të cilën është paraparë dënimi me burgim deri në tre (3) vjet, andaj sipas këtij aktvendimi, e drejta e të dëmtuarit respektivisht rrjedhja e afatit

¹ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme e Kosovës Rev.nr.450/2021

² Aktgjykimi i Gjykatës Supreme e Kosovës Rev.nr.68/2021

për parashkrim i kësaj të drejte fillon të rrjedh nga dita e aksidentit dhe kërkesa e paditësit për shpërblim të dëmit parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale.

Me nenin 106 par.1 nën par.1.3. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës është përcaktuar se: *“Përveç nëse shprehimisht parashihet ndryshe me këtë Kod, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar afatet e mëposhtme:; 1.5. tre (3) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se 1 (një) vit burgim;”* afati për parashkrimin relativ të ndjekjes penale, ndërsa me nenin 107 të të njëjtit ligj me të cilin është rregulluar fillimi dhe ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale, me paragrafin 1 është paraparë se: *“Afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon nga dita kur është kryer vepra penale. Nëse ndonjë pasojë që përbënë element të veprës penale shfaqet ma vonë, afati parashkrimit fillon të rrjedh nga ajo kohë.”*, kurse me paragrafin 7 është përcaktuar se: *“Pas çdo ndërprerje fillon të rrjedhë afati i ri i parashkrimit.”*, ndërsa me paragrafin 8 të të njëjtit nen është përcaktuar se: *“Ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.”*, afati për parashkrimin absolut i ndjekjes penale. Andaj, në bazë të kësaj nga dita e ndodhjes së aksidentit 05.06.2018 nga kjo datë e deri me datën kur është ushtruar padia e paditësit ndaj të paditurës së parë “BIK” datë 04.10.2018 (ndaj të cilës është tërhequr tani padia), respektivisht ndaj të paditurës së dytë KBI dhe KEDS datë 30.03.2022, nuk ka kaluar afati prej 6 (gjashtë) vitesh për parashkrimin absolut në të cilin thirret pala e paditur e rrjedhimisht mbi këtë bazë nuk kemi dhe parashkrim të kërkesës së paditësit.

Gjykata vlerëson se në bazë të lartcekurave nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës së paditësit. Padia është e paraqitur në gjykatë me datë 04.10.2018 ndaj tani ish të paditurës së parë, kurse ndaj të paditurës KBI dhe KEDS me datë 30.03.2022, ndërsa aksidenti ka ndodhur me datë 05.06.2018, ku paditësi kishte pësuar lëndime të rënda trupore dhe kjo lidhet me dispozitën e nenit 358 par.1 të LMD-së, i cili në këtë rast duhet zbatuar lidhur me nenin 368 par.5 lidhur me par.2 si dhe nenit 106 par.1 nën par.1.5., 107 par.1, 7 dhe 8 të KPRK-së Nr. 04/L-082, atëherë për paditësin nuk kemi parashkrim të kërkesëpadiisë ndaj të paditurave, meqë gjykata vlerëson se në këtë rast duhet zbatuar afatin e privilegjuar nga neni 358 par.1 të LMD-së.

Meqë ishte kontestuese baza juridike sa i përket shkaktarit dhe kontributit të palëve në shkaktimin e aksidentit ku ka pësuar lëndimet trupore këtu paditësi i mituri, Gjykata për ta vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, me qëllim të eliminimit të këtyre dilemave aprovoi propozimin e të autorizuarit të të paditurës KBI dhe KEDS, që në cilësinë e dëshmitarit të bëhet dëgjim i dëshmitarit I. H., gjegjësisht dëshmitari N. F..

Dëshmitari I. H., ndër tjera në dëshminë e tij ka deklaruar se në kohën kur ka ndodh aksidenti, kam qenë i punësuar si imam në atë xhami. Ka shtuar se unë nuk kam qenë i caktuar dhe nuk jam përgjegjës për mbikëqyrjen e punimeve qoftë të ndërtimit, mirëmbajtës apo çfarë do tjetër. Unë nuk kam qenë prezent në kohën e aksidentit në objektin në ndërtim e sipër. Sa i përket asaj se gjatë ndërtimit të objektit në kohën kur ka ndodh aksidenti se a ka qenë i siguruar me çfarëdo mënyre vendi i punimeve qoftë objekti apo rreth tij kjo çështje nuk me kujtohet. Në fillim ka filluar punime e ndërtimit të objektit “B. C.” diku pas një viti e me vonë kanë vazhduar punimet

nga persona vullnetar. Ndërsa, në kohën kur ka ndodh aksidenti nuk e di kush ka qen duke i kryer punët ne ndërtimin e objektit. Se kush i mbikëqyrë punimit në objektet e ndryshme të KBI në Podujevë nuk kam njohuri. Ka theksuar se objekti posedon leje nga organet kompetente për ndërtimin e saj, e cila i është lëshuar K. të B. I. në Podujevë.

Ndërsa në pyetjen: A ju kujtohet se a keni parashtruar ndonjë kërkesë te KEDS për bartjen e kablllove elektrike? Është përgjigjur: Po e kemi bërë, të cilën kërkesë e kam bërë unë si imam i xhamisë, në “KEDS” dhe në “E. B.” - fabrika e bllokave. Përgjegjës nuk kam qenë për mbikëqyrjen e punimeve as nuk e kam në përshkrimin e detyrave të punës po një kërkesë të tillë e kam bërë për arsye se është paraqit rrezik gjatë namazit të cilin e ka kryer gjemati prezent. Se ka qenë rrezik këtë e ka konstatuar KEDS pasi që kanë vizituar objektin dhe rrjetin. Edhe në kohën kur ka ndodh aksidenti podrumi i xhamisë ka qenë i kryer në tërësi, ndërtimi mbi podrum ka qenë duke u ndërtuar – kanë qenë duke u kryer punimet në ndërtimin e objektit. Fëmija është lënduar në katin e parë (Mbi Përdhesën). Pa rregullsi nuk ka pas, mirëpo kërkesën për largim e kemi paraqitë, kur ka shkuar objekti lartë e kemi pa se ai tel – kablllo ka paraqitë rrezik. Ato janë mënjanu sipas mej me një vonesë të madhe nga ana e KEDS-it, kërkesa është bërë diku 1 muaj para aksidentit ndërsa janë mënjanuuar menjëherë pas aksidentit. Procedurat e rregullat i ka ndjek KBI në Podujevë, ndërsa kërkesa për mënjanim e rrjetit është bërë kur është parë rreziku. Se a kemi marrë përgjigje me shkrim nuk me kujtohet po ka ndal në vendin e ngjarjes dhe kanë konstatuar se ekziston rreziku mirëpo, për këtë nuk me kujtohet se kanë bo me shkrim, kjo ka ndodh në momentin pasi e kemi bërë kërkesën para ndodhjes se aksidentit. Është e vërtetë se ata na kanë vizituar por nuk e di saktë datën, mirëpo e di se Euro Bllok dhe KEDS janë dalë bashkë dhe na kanë njoftuar se është rrezik për njerëzit vazhdimi i punimeve në objekt është fjala për kabllon elektrike. Komunikimet me KEDS-in i kam bërë në cilësinë e imamatit të xhamisë si punëtor i KBI në Podujevë.

Dëshmitari N. F., ndër tjera në dëshminë e tij ka deklaruar se fillimisht B. I. e Podujevës ka bërë kërkesë për pëlqim parimor e cila i duhet për ndërtim. Pasi që e ka marr KEDS këtë kërkesë është një person përgjegjës që del në teren për të parë a i plotëson kushtet për ndërtim, ai person gjithëherë e kërkon udhëheqshin apo dikën të zyrës në Podujeve në këtë rast më ka kontaktuar mua për ti treguar ku gjendet kërkesa. Kemi dalë në vendin e ngjarjes kemi telefonuar imamin I. H. që të jetë prezent me rastin e shikimit në lokacion ku do të bëhet ndërtimi i objektit, aty kemi vërejt se kalon një linjë 10kw, dhe kemi biseduar se pëlqimi- pranimi iu ipet me një vërejtje që nuk guxon ti ofroresh 3 deri në 5 metra afër kësaj linje.

Pas një kohe kemi dalë bashkërisht me përfaqësuesit e “E. B.” të cilët kanë kërkuar prej meje që të inspektohet objekti i cili ka filluar të ndërtohet afër linjës 10kw, ku kemi vërejt se përçuesi ka prek në shufrën metalike të vendosur në stub – shtyllën e ndërtesës, në atë rast e kam hartuar procesin të cilin e ka shkruar- konstatuar se për shkak të rrezikshmërisë duhet ti ndërpriten punimet deri sa të bëhet një zgjidhje, dislokimi apo largimi i përçuesit që të largohet rreziku çoftë për njerëz apo për objektin në ndërtim dhe për rrjetin elektrik.

Me këtë rast ka qen prezent hoxha I. H. të cilit me këtë rast ia kam dhënë një proces me atë se çfarë është konstatuar dhe këtë e kemi obligim nga detyra e punës që ta ketë parasysh atë që është konstatuar e në veçanti për rrezikun e konstatuar që të tërhiqet vërejtja pas një kohe e nuk me kujtohet sa më ka telefonuar policia që të lajmërohem ne Stacionin Policor në Podujevë se

ka ndodh një rast kontakt me telat e rrymës, kam shkuar në stacionin policor aty jam njoftuar që fjala është për xhamin objektin në ndërtim.

Linja 10kw, është pronë e fabrikës E. B. të cilën e mirëmban vetë pronari dhe e inspekton vetë pronari. Për shkak të rastit të njëjtën kërkesë e kemi trajtuar me urgjencë andaj KEDS-si e shqyrtuar kërkesën për dislokim - zhvendosje të kabllor 10kw. Përndryshe në rast të rregullat nuk intervenon KEDS pasi nuk është pronar i linjës 10kw. Me këtë rast gjithashtu merret edhe pëlqimi nga pronari për dislokimin e kabllor si në rastin konkret.

Gjykata dëshmisë së dëshmitarit I. H., i dha pjesërisht besimin meqë e njëjta sipas vlerësimit të gjykatës ishte e njëanshme subjektive dhe e pa mbështetur në prova sidomos në atë kur thirret se nuk i kujtohet se vendi i ndërtimit a ka qenë i siguar apo jo në kohën e aksidentit, e shumë deklarime të tjera të tij janë kontradiktore në vetë vete dhe me njëra tjetrën, e krejt kjo sipas vlerësimit të gjykatës me qëllim të shmangies së përgjegjësisë për vete dhe për të paditurën KBI. Ndërsa gjykata ka pranuar në tërësi si të besueshme dëshminë e dëshmitarit N. F., meqë gjykata vlerësoi se ai është deklaruar në mënyrë objektive, ngase dëshmia e tij përputhet në tërësi me thëniet në padi të palës paditëse, dhe në përputhje të plotë me provat tjera dhe bindëse. Andaj, gjykata vlerësoi se nuk ka pse mos ta pranoi si dëshmi të besueshme.

Gjykata, duke u nisur nga fakti se baza juridike edhe më tej mbetet kontestuese, për ta vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe për të vërtetuar kontributin e pjesëmarrësve në shkaktimin e aksidentit në punë e me qëllim të eliminimit të dilemave aprovoi propozimin e të autorizuarit të paditësit dhe nxori provën me ekspertizën nga Mbrojtja e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë, nga ekspertit gjyqësor Dr. Sc. Gj. V., Ekspert për Mbrojtje dhe Siguri në Punë, i cili në konstatimin dhe mendimin e tij me shkrim të datës 03.05.2023, ka ardhur në përfundimin se:

Në bazë të konstatimeve të mësipërme jap këtë përfundim:

1. Përgjegjësi punëdhënësi ka të bëjë me mosrespektimin e urdhëresave nga KEDS-si për ndërprerjen e punimeve derisa të zhvendosen shtyllat, kurse
2. Përgjegjësi e KEDS-it ka të bëjë me zvarritjen e zhvendosjes së shtyllave të tensionit të lartë.

Deri te një përfundim i tillë eksperti ka ardhur nga fakti se ka konstatuar se:

A. Punëdhënësi

1. Me datën 06.10.2016-Eshtë dhënë leja për ndërtimin e objektit fetarë-Xhamisë ne Podujevë, lagjja "M." (dimensionet e objektit 18.5 XI 7.5 m),
2. Me 21.06.202016- KEDS ka dhënë pëlqimin Parimor me vërejtje që afër objektit ku do të ndërtohet objekti nuk guxojnë ti afrohen tensionit (kabllorve) të rrymës në distancë horizontale dhe vertikale minimum 3-5m' (kopje e dokumentit është dëshmi),

3. Imami i Xhamisë, z. I. H. ka deponuar në zyrat e përkujdesjes së konsumatorëve-KEDS njësia Podujevë një shkresë me të cilën ka kërkuar që të dislokohet rrjeti nga afërsia e murit (pasi që objekti veç kishte filluar të ndërtohej, (nuk ka datë se kur është dorëzuar kjo shkresë vetëm nga dëshmitë, provë),
4. Pas shkrësës së Imamit (N. F.-KEDS) ka dalë prapë në vendngjarje dhe ka konstatuar se:
 - Rrjeti ishte shumë afër me pak se 50 cm,
 - Ka njoftuar Imamin se rrejtja është prone e Fabrikës "E. B." në rrugën S...

Citat “*Kam kërkuar nga imami që të ju drejtohet me kërkesë Hekurudhave të Kosovës dhe Euro Bllok-ut për dislokim të rrjetit. Që të dy kompanitë kanë dhënë pëlqimin (hekurudhat jo distancën e mjaftueshme për dislokim)*”.

5. Me datë 24.04.2018 Punëtori i KEDS-it, N. F. dhe Li. B. punëtori i E.. kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe ia kanë tërhequr vërejtjen Imamit për ndërprerjen e punimeve (procesverbali Nr.), sepse po rrezikohet jeta e njerëzve pasi kabllot kishin prekur shufrat metalike të armaturës në shtyllat e betonit gjatë ndërtimit,
6. Nga dëshmia e Imamit, me datën 15.05.2015 janë vendos shtyllat e betonit në pozitat për dislokim.

B. PUNËKRYESIT

1. **Punëkryesit** kanë qenë vullnetar të angazhuar nga K. i B. I. - Podujevë.

C. INSPEKTORIJATI

1. Nuk ka asnjë dëshmi me shkrim se Inspektorati Republikan apo Inspektorati Komunal ka vizituar vendin e Aksidentit.

Kjo mund të ketë ndodh për shkak se numri i personelit është shumë i vogël dhe nuk ka arrit të vizitohet, që duhet të alarmoj organet shtetërore që numri i tyre të rritet sepse ka shumë lëndime dhe vdekje në vendet e punës që shoqërisë i kushtojnë më shumë se sa të rrisin numrin e të punësuarve në këtë fushë.

Të cilin konstatim dhe mendim eksperti e ka mbajtur dhe në seancën e datës 18.07.2023, ku ka dhënë përgjigjet e tij në vërejtjet dhe pyetjet e palëve ndërgjyqëse. Ku ndër të tjera në të përgjigjur të pyetjeve ka theksuar se: “*Sa i përket dislokimit unë mendoj që prapë se prapë është përgjegjësi e KEDS që të bëjë dislokimin e rrjetit ose së paku të jap leje për dislokim. Kjo për arsye se kompanitë private nuk kanë kapacitete profesionale për dislokim, për derisa KEDS-i ka dhënë një pëlqim parimor për ndërtim të objektit ku edhe ashtu e parasheh edhe dislokimin e rrjetit ... nga përvoja ime në kompani publike rrjeti pas pranimit teknik kalojnë pronë të*

kompanive. Për këtë sa KEDS ka lëshuar pëlqimin parimor për objektin është dashtë që ta parasheh rreziqe që mund të vijnë nga kjo mos dislokim i rrjetit ...”, si dhe ka theksuar se: “po ishte dashtë të ndërpriten punimet por nuk mbaron këtu përgjegjësi e punëtorit të KEDS është dashtë të njoftohet edhe inspektorati i punës për mos ndërpritje punimeve në mënyrë që ata ti ndërpresin punimet. Sikur të ishte njoftuar inspektorati i punës nga ana e KEDS përgjegjësia e KEDS do te ishte zero ... pse kanë shkuar punëtorët e KEDS te punishtja? Kanë shkuar sepse KEDS ka nënshkruar një pëlqim parimor ku kanë dhënë disa kushte që ky objekt të ndërtimit duhet të ndërtohet në këto kushte që janë përshkruar në pëlqimin në shkresat e lëndës. Aty një prej kushteve është nuk guxon ti ofrohet lart përcuesit 3 deri ne 5 metra. Do me thënë kjo e obligon KEDS-in në imponimin e kushteve në pëlqimin parimor të cilën e ka lëshuar KEDS. Andaj nga e gjithë këto rrjedh obligimi ishte dashtë që të njoftohej inspektorati nga ana e KEDS ... KEDS ka për obligim të imponoj aplikimin e kushteve që i ka dhënë në pëlqimin parimor jo ta mbikëqyr ndërtimin.”

Gjykata në rastin konkret konstatimit dhe mendimit të dhënë në ekspertizën e ekspertit nga mbrojtja dhe siguria në punë Gj. V., e pranoi në tërësi si të bazuar dhe i dha besimin e plotë, e cila ekspertizë vlerësoi se ka elemente të mjaftueshme dhe të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale e shkencore, është e argumentuar në fakte dhe arsye të mjaftueshme, për vërtetimin e kësaj çështje kontestimore, me çka përfundimisht vërtetohet dhe lidhja kauzale shkak pasojë por dhe legjitimiteti pasiv i të paditurave, andaj dhe i fali besimin e plotë.

Gjykata në bazë të gjithë kësaj erdhi në përfundim se dy të paditurat kanë dhënë kontribut që të vije deri te aksidenti ku ka pësuar lëndime paditësi i mituri, andaj dy të paditurat ndajnë përgjegjësinë lidhur me aksidentin e shkaktuar ashtu që duke vlerësuar provat e lartpërmendura, gjykata konsideron se shkaktar kryesor të aksidentit pra janë të paditurat KBI dhe KEDS, me mos ndërmarrjen e masave për sigurimin e vendit të punimit dhe evitimin-dislokimin e kabllos 10kw, e cila siç u konstatua ka qenë rrezik real dhe permanent për të gjithë ata që kanë gravituar aty meqë dhe vendi i punimeve nuk ka qenë i siguruar dhe puna është kryer vetëm nga punëtorët vullnetar pa ndonjë organizim të duhur dhe pa asnjë masë mbrojtëse, me mos imponimin e kushteve që i ka dhënë në pëlqimin parimor, si dhe me mos njoftimin e organeve kompetente Inspeksionit të Ndërtimit apo organeve tjera kompetente edhe pse kanë pasur njohuri që të dy të paditurat për rrezikun e lartë që ka ekzistuar. Në këtë rast gjykata pati parasysh nenin 190 paragrafi 1 i Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve – LMD-së, i cili ka përcaktuar se: “*Për dëmin të cilin disa persona e kanë shkaktuar bashkërisht, përgjigjen të gjithë pjesëmarrësit solidarisht.*”, ndërsa me nenin 190 paragrafi 4 është paraparë se: “*Kur nuk ka dyshim se dëmin e ka shkaktuar ndonjë nga dy ose nga më tepër persona të caktuar, të cilët në ndonjë mënyrë janë të ndërlidhur midis tyre, ndërsa nuk mund të përcaktohet se cili prej tyre e ka shkaktuar dëmin, këta persona përgjigjen solidarisht.*”

Kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqjësë ishte po ashtu dhe lartësia e kërkesëpadisë së precizuar nga i autorizuari i paditësit me parashtrësën e datës 28.09.2023 të dorëzuar në gjykatë.

Gjykata për ta vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë, me propozimin e të autorizuarit të paditësit, aprovoi propozimin që të bëhet nxjerrja e provës me anë të ekspertizës mjekësore nga ana e

ekspertëve gjyqësor Dr. S. D., ekspert i ortopedisë-traumatologjisë, Dr. B. B., ekspert Kirurg dhe ekspertit gjyqësor Dr. Sh. H., ekspert i psikiatrisë, të cilët në bazë të mendimit të tyre të dhënë me shkrim të dt.24.08.2022, të bazuar në provat materiale në shkresat e lëndës si dhe ekzaminimin e drejtpërdrejt të paditësit, kanë dhënë mendimin e tyre profesional, ku kanë konstatuar se paditësi ka pësuar këto lëndime trupore si:

Djegie me rrymë e shkallës së II B-III në regjionin e gjoksit ana e djathtë, regjionin e krahut të djathtë, djegie rryme në regjionin gluetal dhe femoral-kofshës së djathtë, djegie rryme në regjionin e nën gjurit të djathtë sipas klasifikimit TBSA në sipërfaqe trupore prej 10-20%, defekt i lëkurës dhe indit nën lëkuror në regjionin e femurit-kofshës dhe gluetal të anës së djathtë. Si pasojë e lëndimeve të sipërpërmendura me anë të rrymës elektrike, paditësi i mitur ka qenë trajtim hospitalor prej datës 06.06.-07.07.2018, ku i është nënshtruar edhe ndërhyrjeve kirurgjike me datën 08.06.2018 dhe me datën 26.06.2018 (shih fletlëshimin).

Lëndimet e tilla kualifikohen si lëndime të rënda trupore me pasoja të përhershme, me ç'rast paditësi ka përjetuar dhimbje fizike me intensitete të ndryshëm dhe atë: të intensitetit posaçërisht të rëndë, që ka zgjatur për 1 orë, që nënkupton dhimbjet në momentin e kadietit-mekanizmin e lëndimit, natyrën e lëndimit trupor, dhënien e ndihmës së parë etj. Dhimbje fizike të intensitetit të rëndë që kanë zgjatur për 72 orë, për shkak të lëndimeve të lartcekura me theks të veçantë në regjionin e gjoksit, kofshës së djathtë gluteusit të djathtë dhe nën gjurit të djathtë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur për 6 javë, për arsye të dhimbjeve të sipërpërmendura për çka dëshmon dhe dokumentacioni mjekësor, dhimbje të intensitetit më të ulët kanë qenë prezentë në periudhë prej 3 vitesh herë pas here të cilat manifestohen edhe tani sidomos gjatë ndryshimeve klimatike, pozitive të detyruara dhe ngarkesave fizike si dhe kontaktit të papërshtatshëm direkt me objekte.

Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor kanë konstatuar dhe atë në shkallë prej 10%, që manifeston vrapa të thella të lëkurës pas djegieve ose lëndimeve pa pengesave në motilitet-lëvizje që përfshinë 20% të sipërfaqes trupore.

Shëmtim trupor ka dhe atë në shkallë të mesme për shkak të vrapave-shenjave si pasojë e defektit të indit lëkuror dhe nën lëkuror të cilat janë të dukshme për ambientin e jashtëm në raste të veçanta duke marrë parasysh edhe moshën e të lënduarit dhe gjendjen e statusin e tij që manifestohet me problem klinik në kuptimin e dhembjeve sidomos gjatë kontaktit direkt me objekte të jashtme me të cilën e kufizon edhe nga aktivitete e dëshirueshme.

Përkujdesja e personit të tretë ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 8 javëve, në kuptim të ndihmës të aktiviteteve të përditshme jetësore siç janë ushqimi, veshmbathja dhe higjiena dhe ndihma gjatë trajtimit mjekësor. Ndërsa ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 6 jave, i pasur me proteina, minerale, vitamina, po ashtu rehabilitimi fizioterapeutik ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej dy (2) herë nga dy (2) javë, në vitin e parë pas aksidentit.

Me rastin e aksidentit paditësi ka përjetuar frikë të intensitetit dhe atë: frikë primare ka zgjatur 1 (një) sekonde, meqë ka shkelur në disa kablla rryme ku me këtë rast ka arritur të shohë perceptoj momentin e goditjes, frikë sekondare të intensitetit të lartë e cila ka zgjatë për 27 ditë,

meqë nga momenti pas përfundimit të aksidentit kur është këndellur, kur ka kuptuar se çfarë ka ndodhur me të, i ka ndjerë lëndimet, vuajtjet dhe dhimbjet e lëndimit, në mënyrë rapide kanë filluar ankthi, habija, frikë, dhimbje fizike dhe vuajtjet shpirtërore deri në përfundimin e trajtimit kirurgjik dhe shëndetësor në Klinikën e Kirurgjisë Plastike. Të gjitha këto gjetje dhe kjo gjendje psiko-fizike qojnë në konstatimin se paditësi kishte përjetuar frikën e tillë.

Frika sekondare e intensitetit të mesëm që ka zgjatur për 2 muaj, është gjendja pas daljes nga klinika dhe vazhdimi i trajtimit shëndetësor në shtëpi, në të njëjtën kohë kanë vazhduar peripecitë si ndrojtja, frika, ankthi etj., me shqetësime të ndryshme. Kjo ka kaluar në Frikë sekondare të intensitetit të ulët e cila ka zgjatur edhe për 2 muaj tjerë, janë shqetësime të kohëpaskohshme, si frika, pagjumësia, shqetësimet e karakterit ankcioz, rikujtime për ngjarjen traumatike si dhe vështirësi në adaptimin në aktivitetet jetësore.

Pasi që u vërtetua baza juridike e kërkesëpadisë atëherë gjykata vendimin lidhur me dëmin jo material dhe material e ka bazuar në konstatimin dhe mendimin e ekspertizës së ekspertëve mjekësor të përbërë nga Dr. S. D. ekspert i ortopedisë-traumatologjisë, Dr. B. B., ekspert i Kirurgjisë dhe ekspertit gjyqësor Dr. Sh. H., eksperte psikiatër, të cilët janë deklaruar lidhur me lëndimet e paditësit duke aprovuar këto shuma.

Andaj, gjykata duke u bazuar në provat e administruara, mendimit të ekspertëve të dhënë në ekspertizën e tyre me shkrim, paditësit iu aprovuan shumat për kompensimin e dëmit si në dispozitiv të aktgjykimit dhe atë: në emër të dëmit jo material për dhimbjet fizike shumë prej 4,600.00 €, në emër të frikës së përjetuar shumë prej 4,400.00€, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor (në shkallë 10%) shumë prej 4,500.00€, si dhe në emër të shëmtimit trupor në shkallë të mesme (për shkak të vrazave-shenjave si pasojë e defektit të indit lëkuror dhe nën lëkuror të cilat janë të dukshme për ambientin e jashtëm në raste të veçanta) shumë prej 3,800.00€, kurse ju refuzua shuma përtej shumës së gjykuar si tejet e lartë dhe jo në harmoni me lëndimet e paditësit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve dhe frikës së përjetuar, si dhe pasojat e mbetura tek paditësi si pasojë e aksidentit të pësuar.

Ndërsa, iu aprovuan kërkesat nga gjykata në emër të kompensimit të dëmit material edhe pse nuk kishte prova me të cilat do të dëshmohej se kush është përkujdesur për paditësin cili person e që zakonisht anëtarët e familjes kujdesen dhe i japin ndihmë dhe se çfarë ushqimi të përforcuar ka përdorur i njëjti e që në këtë rast ka pasur nevojë për ushqim të pasur me proteina, albumina, minerale, vitamina, ushqim më i përforcuar se ai zakonshmi siç është konstatuar dhe nga ekspertiza e ekspertëve mjekësor, duke aprovuar shumat dhe atë: për ndihmën dhe përkujdesjen e huaj shuma prej 500.00€, për ushqim të përforcuar shuma prej 420.00€, duke u mbështetur në mendimin e dhënë nga eksperti i ortopedisë-traumatologjisë dhe kirurgjisë, duke konsideruar se paditësi vërtetë bazuar dhe në lëndimet e pësura ka pasur nevojë për kujdes të personit të tretë dhe ushqim të përforcuar. Këto kërkesa iu aprovuan bazuar dhe në praktikën gjyqësore të krijuar nga gjykatat e instancës më të lartë me vendimet e tyre dhe se shumat e aprovuara janë proporcionale me dëmin e shkaktuar për këto kategori, kohëzgjatjen e nevojës për ndihmë dhe kujdes të huaj dhe ushqim të përforcuar. Kurse i refuzoj shumë tjetër të kërkuar përtej shumës së aprovuar si të pa bazuar, tejet e lartë dhe jo në harmoni me lëndimet e pësura si dhe

kohëzgjatjen dhe nevojën e këtyre kërkesave, e cila ishte në kundërshtim dhe me praktikën gjyqësore.

Kurse, ju refuzua kërkesa në emër të rehabilitimit klimaterik-fizioterapeutik nga gjykata si e pabazuar, në mungesë të provave, meqë paditësi nuk ka ofruar asnjë provë se ku ka qenë për rehabilitim çfarë do qoftë ai (në banjë, tek fiziatrri, psikiatri etj.), e që këtë e kërkon dispozita e nenit 7.1 lidhur me nenin 319.1 dhe 2 të LPK-së, por nuk e bëri këtë, dhe jo në harmoni me lëndimet e paditësit, praktikës gjyqësore dhe Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata në rastin konkret konstatimit dhe mendimit të dhënë në ekspertizat e ekspertëve mjekësor i pranoi në tërësi si të bazuara dhe iu dha besimi e plotë, të cilat ekspertiza kanë elemente të mjaftueshme dhe të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale e shkencore, të argumentuara me prova dhe arsye të mjaftueshme, për vërtetimin e kësaj çështje kontestimore.

Gjykata shumat e aprovuara i bazoj në dispozitat e nenit 183 par.1 dhe 2 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së), mendimit të ekspertëve, praktikës gjyqësore për këto kategori të dëmit, në veçanti moshën e re të paditësit (në kohën e aksidentit ka qenë i moshës 9 vjeçare), llojin e lëndimeve, frikën e përjetuar, pasojat e mbetura tek paditësi nga ky aksident pasoja këto të përhershme e që do ta përcjellin gjatë gjithë jetës, marrë parasysh po ashtu statusin e tij për shkak të moshës, duke pasur parasysh çdo herë parimin që lartësia e shpërblimit të dëmit të jetë në harmoni me rëndësinë e cenimit të së mirës së shkelur dhe qëllimit që i shërben ky shpërblim, si dhe atë që mos të favorizohen synimet e njëjës palë e dëmtimit të palës tjetër të cilat nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe qëllimin shoqëror, duke pasur parasysh dhe parimin që të mos dëmtohet njëra palë dhe të pasurohet pala tjetër pa bazë.

Gjykata vlerëson se shpërblimi i dëmit për paditësin ndoshta nuk është shpërblim i plotë por është satisfaksioni më real i mundshëm për të, e që në rastin konkret shumat e aprovuara janë të drejta për paditësin.

Gjykata i pati parasysh edhe kundërshtimet e përfaqësuesve të të paditurave, e që pjesërisht i aprovoi sidomos të aprovimi i shumave për kompensim, për të cilat u vërtetua se ekziston lidhja kauzale e lëndimeve me rastin e aksidentit ku paditësi ka pësuar lëndimet trupore dhe të paditurat mbajnë përgjegjësinë për kompensimin e dëmit siç parashihet konform dispozitave të nenit 179 par.1 i cili ka përcaktuar se: *“Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit.”*, si dhe nenit 154, 155 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së).

Gjykata duke u bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike si më lartë, vlerësoi se të paditurat mbajnë përgjegjësi për dëmin që i është shkaktuar palës paditëse, me rastin e lëndimit dhe dëmit të pësuar, në aksident, për çka të paditurat janë obliguar që t’ia kompensojnë në mënyrë solidare mbi bazën e përgjegjësisë së të paditurave, konform dhe dispozitave të nenit 136, 137, 140, 169, 179, 183, 190 par.1 dhe 4 si dhe nenit 382 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së), dhe praktikës gjyqësore.

Gjykata lidhur me kërkesën për kamatën ka vendosur në mbështetje të nenit 382 të të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Kosovës (LMD-së) si dhe pikës VI lidhur me pikën XV të Mendimit Juridik për Kamatën Nr. 265/2020 të datës 02.12.2020 të Gjykatës Supreme të Kosovës, nga data e seancës së shqyrtimit kryesor datë 25.10.2023, sepse nga kjo datë të paditurat kanë ra në vonesë për përmbushjen e detyrimit, kurse pala paditëse ka marrë njohuri për format dhe lartësinë e dëmit, duke ju refuzuar kërkesa e palës paditëse si e pa bazuar që për shumat e aprovuara të detyrohen të paditurat t'ia paguajnë me kamatë ligjore 12% sipas nenit 382 të LMD-së, nga dita e paraqitjes së padisë.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore u mor konform dispozitave të nenit 449, 450, 452.2 dhe 453.1 të LPK-së, Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore dhe Rregullores për Tarifat e Avokatëve të Odës së Avokatëve të Kosovës (2017), duke detyruar të paditurën që t'ia paguaj shpenzimet e procedurës sipas shkallës së përgjegjësisë dhe duke marrë për bazë vetëm ato shpenzime të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjykatë dhe suksesin që paditësi pjesërisht pati sukses në kontest, atij ju pranua shuma e përgjithshme prej 3,562.00 €, dhe atë për përpilim të padisë shumën prej 312€, për 8 përfaqësime të avokatit në seanca shumën prej nga 300€ për një seancë, në shumë të përgjithshme prej 2400€, për shpenzimet e ekspertizës mjekësore shumën prej 450€, shpenzimet e ekspertizës së sigurisë dhe mbrojtjes në punë në shumën prej 150€, si dhe shumën prej 100 € në emër të taksës gjyqësore të paguar për padi, kurse pjesa tjetër ju refuzua e pa bazuar konform dispozitave të nenit 452.2 dhe 453.1 të LPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.492/2018, me datën 01.11.2023**

Gjyqtari:
Nazmi Neziri

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.